



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 34, Datë 28.02.2022

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 263/3 prot., datë 21.02.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 377, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike që nga data 27.07.2017, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri në datën 27.07.2022, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 251 prot., datë 10.02.2022, ka paraqitur kërkesën për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe Dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga aplikimi është konstatuar mungesë e theksuar e dokumentacionit si vijon:  
Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (*Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë*). **Plotësuar pjesërisht.** Mungojnë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin.
- **gërma “e”** (*Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse*). **Plotësuar pjesërisht.** Mungon Struktura në formë skematike dhe çdo dokument që disponon shoqëria (marrëveshje/kontratë) në lidhje me shërbimin që ofron për këtë veprimtari grupi inxhiniero-teknik i kompanisë mëmë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (*Vërtetim për shlyerjen e Tatim - Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore*) **Plotësuar pjesërisht.** Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”** (*Bilanci financiar i tre viteve të fundit*). **Plotësuar pjesërisht.** Mungojnë pasqyrat financiare të audituara për vitin 2018.
- **gërma “c”** (*Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit*) **Pa plotësuar.** Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë.

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.8:

- **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); **Pa plotësuar.** Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike bazuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 377, Seria T17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, data 27.07.2017,
2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e këtij vendimi të bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**